

VENDIM
Nr. 27, datë 23.6.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR
ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E SEANCËS DËGJIMORE ME PUBLIKUN
NË PROCESIN E MIRATIMIT TË TARIFAVE”**

Në mbështetje të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik” dhe të “Rregullores për organizimin e brendshëm të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura”, Komisioni Kombëtar Rregullator,

KONSTATOI SE:

Rregullorja “Për organizimin dhe zhvillimin e seancës dëgjimore me publikun në procesin e miratimit të tarifave” është miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 71, datë 21.9.2018 dhe është ndryshuar me vendimin nr. 54, datë 14.4.2020. Kjo rregullore shërben për të përcaktuar procedurat që duhet të ndiqen nga operatorët për organizimin dhe zhvillimin e seancës dëgjimore me publikun si pjesë e dokumentacionit të procesit për aplikim për ndryshim të tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime.

Me vendimin e Komisionit nr. 539, datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime” janë përcaktuar metodologjitë e reja për miratimin e tarifave si dhe me daljen e VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, me qëllim përshtatjen e seancës dëgjimore me këto dy vendime, del e nevojshme kryerja e disa shtesave dhe ndryshimeve në këtë rregullore.

Sa më sipër, në mbledhjen e datës 23.6.2023, Komisioni Kombëtar Rregullator:

VENDOSI:

1. Në “Rregulloren për organizimin dhe zhvillimin e seancës dëgjimore me publikun në procesin e miratimit të tarifave” të miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 71, datë 21.9.2018” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- a) në nenin 3, paragrafi i fundit shtohet në fjalinë hyrëse përkufizimi “Shoqëri Rajonale UK”;
- b) në nenin 5, pika 2, nënpika 4, shtohen fjalët “në bashkitë përkatëse”;
- c) në nenin 6, pika 2, hiqet fjalia “që në zonën e tyre të shërbimit mbulojnë më shumë se një bashki”;
- ç) në nenin 7, pika tre pas fjalës së fundit shtohet fjalia “ dhe në rrjetet sociale të shoqërisë UK.”;
- d) në nenin 9, pika 2, pas fjalisë së parë shtohet fjalia “ gjithashtu përfaqësues të Aksionarëve”;
- dh) në nenin 13, fjalia e parë ndryshohet “I gjithë dokumentacioni i organizimit të seancave dëgjimore”;
- e) në shtojcën nr. 1, tabelat nga nr. 1 deri në nr. 10 zëvendësohen me tabelat nga nr. 1 deri në nr. 10, bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjitha shoqëritë ujësjellës-kanalizime dhe Enti Rregullator i Ujit.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani